

ALBANIAN POST

**Nr.
83**

**KORRIK /
JULY
2025**

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



17 Model...



07 Arsyet...



12 Bejka...



18 Ndue...

“FJALA E LIRË”, KUVEND ZEMRASH TË BUKURA

Nga Viron Kona

Duke të shprehur mirënjohjen time, dëshiroj të them se ne që mbledhemi prej dekadash te “Fjala e lirë”, që ti drejton, ndihemi si në një kuvend zemrash të bukura, ne aty shkruajmë dhe përcjellim idetë, mendimet dhe mesazhet tona, të bindur se dëgjohemi dhe vlerësohemi, fjala jonë respektohet në radhë të parë nga ty, por dhe nga poetë, shkrimtarë, prozatorë, artistë dhe lexues të shumtë, që e gjallërojnë dhe i japin energji “Fjalës së lirë”.

Gjithnjë kam pasur bindjen se kuvendi ynë i “Fjalës së lirë, s’njeh as gardhe dhe as kufij, ai do të vazhdojë gjatë rrugëtimin e tij, sepse...

(vijon në faqen 02)



SUPERMARKETI I SHQIPTARËVE

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi i shqiptarëve në Kilburn High Road. Aty ku nën drejtimin e biznesmenit Mahmut Siringul do të gjeni të gjithë produktet e cilësisë lartë dhe me çmime konkurruese.

KUALITET - CILËSI

02073721059

22-324 Kilburn High Road, NW6 2QN

MIRË SE VINI!

WWW.FJALAEIIRE.COM

(vijon nga faqja 01) ...është shndërruar prej kohësh në një dritë - përhapës, por ai do të jetë edhe një dëshmi që do t'u përcillet brezave për t'u treguar fuqinë, energjinë dhe çiltërsinë e mendimit të lirë dhe të bukur shqiptar, do t'iu tregojë se, me sa etje dhe dashuri shqiptarët e lirë i kanë kënduar lirisë, demokracisë, traditave të vyera, folklorit, fjalës së bukur shqipe, gjuhës, publicistikës, artit, historiografisë...

Sa herë që ne dërgojmë artikujt apo krijimet tona te "Fjala e lirë", të përfytyrojmë ty i dashur Fatmir dhe ndiejmë se mendimet, krijimet dhe mesazhet tona po ia themi apo po ia përcjellim një shoku të afërt, një shoku të mirë, ia shprehim një kuvendi të dashur dhe të besueshëm, që na respekton dhe na mirëkupton. Na vjen mirë që në krye të këtij kuvendi zemrash të bukura, je ti Fatmir, që mirëpret, respekton dhe përthithë idetë dhe ndjenjat e bukura që i japin "Fjalës së lirë", energji të reja, ide, aroma, ngjyrimë lirie dhe valëvitje të flamurit tonë kombëtar.

Duke të uruar ty sa më shumë shëndet, suksese dhe mbarësi në udhën tënde të ndritur e krijuese, Me shumë respekt, Miku yt, Viron Kona, Tiranë, më 27 qershor 2025. I nderuar miku im, Fatmir Terziu! Të falënderoj nga zemra për përkushtimin e bukur që më bën me rastin e 75-vjetorit të lindjes.

Ky përkushtim i sinqertë, është një dhuratë e vyer, mbresëlënëse dhe e paharruar, që i shtohet buqetës së ditëlindjes sime, si trëndafili më i bukur, plot aromë dhe freski. Gjithashtu, dëshiroj të them se urimi që më dedikon, më vjen nga një mik dhe një shokë i rrallë, i talentuar dhe me kontribute të mëdha në fushën e artit dhe të letrave shqipe. Ta dish që çdo fjalë jotja, është e qëndisur me çiltërsinë e njeriut të vërtetë, të përkushtuar ndaj shoqërisë dhe miqësisë së sinqertë, të përkushtuar ndaj artit dhe letërsisë, ndaj Shqipërisë sonë të dashur.

FLORA'S
Gusto Italian

Flora's
Gusto
Italian

I VLERESUAR
PER
HIGJENE

Restoranti i munguar modern i shqiptarëve

02089047775 DY MINUTA NGJA UNDERGROUNDI PRESTON ROAD

Web: www.rashidandrashidsolicitors.com



- KËSHILA LIGJORE FALAS
- SPECIALIST I AZILIT TË TRAFIKIMIT NJERËZOR
- DOKUMENTE UDHËTIMI
- PROCEDURA PËR LEJE QËNDRIMI
- ZGJATJE VIZASH
- LEJE PUNE RISHIKIM JURIDIK
- APLIKIM TRIBUNALI
- RASTET E TRASHËGIMISË

ZYRA QENDRORE:



020 8540 1666
020 8672 0666

190 Merton High Street
South Wimbledon
London
SW19 1AX

INTEGRITET - SINQERITET



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

KËSHILLA LIGJORE FALAS

Specialist i azilit
të trafikimit njerëzor



- ✚ Dokumente udhëtimi
- ✚ Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- ✚ Apelim Tribunali

Shërbime profesionale

ÇFARË OFROHET

Kur jeni
kontigjent për t'u
riatdhesuar, ose
të ndaluar nga
organet e
emigracionit

Mbulojmë të
gjitha aspektet e
emigracionit

Rastet e
trashëgimisë dhe
të gjitha
procedurat e
nevojshme ligjore

Zgjatje vizash,
leje pune,
rishikim juridik e
mjaft të tjera.

KONTAKTO

24/7

ORË LINJË EMERGJENCE

MOB. 0777 4222 062
078 78335 000

Rashid and Rashid Solicitors po rikthehet më profesional, më
i fuqishëm, dhe më i dedikuar profesionalisht, pasi Gjyqi i dha
të drejtën Ligjore.

INTEGRITET

Shërbim profesional, ligjor
dhe mbrotje e garantuar

WEBSITE

www.rashidandrashidsolicitors.com



ZYRA QENDRORE

190 MERTON HIGH STREET - SOUTH
WIMBLEDON - LONDON - SW19 1AX

TELEFONAT E KONTAKTIT



020 8540 1666
020 8672 0666

SPECA SOMBORKA – TASHMË ME SHUMICË TEK HILALL FOOD CENTER

Sivjet ka sardhur në ndihmë një kualitet më i mirë i specave somborka nga fushat e Kosovës. Dhe ky është dhe në një Njoftim për fermerët dhe bizneset në Kosovë lidhur me grumbullimin e produkteve bujqësore: “Të nderuar, me shumë kenaqësi ju njoftojmë se nga data 15.07.2025 fillojmë me grumbullimin e specave somborka, babure, si dhe pemëve e perimeve të freskëta. Pika grumbulluese: Rahovec, Sopniq. Të gjithë të interesuarit për bashkëpunim janë të mirëpritur te na kontaktojnë tani.” Kohë më parë Drejtoresha e Bujqësisë Lirie Hoti vizitoi disa fermerë. Në kuadër të angazhimit për të mbështetur fermerët llapjanë dhe për të ndjekur nga afër zhvillimin e sektorit të bujqësisë në komunën tonë, Drejtoresha e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Lirie Hoti, realizoi disa vizita



tek fermerë të ndryshëm në Komunën e Podujevës. Vizita e parë u realizua në fshatin Batllavë, tek fermeri Florim Statovci, përfitues i një serre prej 5 ari nga komuna. Fermeri Statovci është i angazhuar në kultivimin e grurit, misrit, specave paprika dhe somborka, si dhe rritjen e pemëve të mollës. Në vijim të vizitave, drejtoresha Hoti ndaloi në fshatin Orllan tek fermeri Enver Derguti, një fermer i dalluar i cili kultivon grurë, misër, patate dhe fasule, si dhe mban një numër të konsiderueshëm të deleve dhe lopëve qumështore

dhe bletëve. Gjithashtu, drejtoresha i vizitoi edhe fermerët Fahrudin Mahmuti nga fshati Siboc i Epërm dhe Albin Rrahimi nga fshati Balloc, të cilët janë kultivues të kulturave të ndryshme bujqësore. Drejtoresha Hoti i përgëzoi të gjithë fermerët për punën e tyre të palodhur dhe përkushtimin në zhvillimin e bujqësisë. Ajo i inkurajoi ata që të vazhdojnë aktivitetet e tyre me përkushtim dhe profesionalizëm, duke theksuar se komuna do të vazhdojë mbështetjen për ta.

Road! Rifurnizimi i radhës vjen javën tjetër. Nëse nuk arritët t'i merni këtë herë, na shkruani ose na telefononi për të rezervuar sasinë që dëshironi. Për shkak të kërkesës së madhe, po zgjerohemi edhe në kohë të tjera ndërmjetëse për të përmbyshur kërkesat e bashkatdhetarëve tanë kudo që janë në Britani të Madhe, thuhet në një bisedë nga pronarët e Hilall Food Center! Kontratat për shitje me shumicë kanë filluar – jemi gati për bashkëpunime në çdo pjesë të Mbretërisë së Bashkuar! Na kontaktoni për porosi dhe bashkëpunim afatgjatë.

DIREKT NGA FUSHA

Fushat e Kosovës

Për shkak të kërkesës së madhe, po zgjerohemi edhe në kohë të tjera ndërmjetëse për të përmbyshur kërkesat e bashkatdhetarëve tanë kudo që janë në Britani të Madhe, thuhet në një bisedë nga pronarët e Hilall Food Center! Kontratat për shitje me shumicë kanë filluar – jemi gati për bashkëpunime në çdo pjesë të Mbretërisë së Bashkuar! Na kontaktoni për porosi dhe bashkëpunim afatgjatë.

- ◆ Somborka
- ◆ Domate
- ◆ Tranguj
- ◆ Perime

Kilburn High Road HilallFood Center

HILALL FOOD CENTER

High Road Kilburn

Direkt nga Fushat e Kosovës

- ◆ Somborka
- ◆ Domate
- ◆ Tranguj
- ◆ Perime

TË FRESKËTA

Hilall Food Center High Road Kilburn

Më tej thuhet se nga zemra ju falënderojmë për besimin dhe përkrahjen që i dhatë prodhimit nga Mamusha. Domatet e freskëta dhe specat Somborka nga Mamusha, Kosovë po shiten në kohë rekord tek Supermarketi Hilall Food Center në Kilburn High

SOMBORKA

NGA FUSHAT E KOSOVËS

KILBURN HIGH ROAD

HILALL FOOD CENTER

FATMIR TERZIU: SATIRA SHQIPTARE NË NJË NIVEL TË LARTË TEK “KANDIDAT PËR KANDIDAT”

Duket se ardhja në duart e lexuesit të romanit të ri të shkrimtarit Arben Çejku, “Kandidat për Kandidat”, është një sinjal i ngjashëm me atë prurje në vitin 2006, të “Kandidati”-it të psikoterapistit, psikodramatistit dhe shkrimtarit argjentinasi Jorge Bucay, kur ky libër u bë i shitur në më shumë se 2 milionë kopje në të gjithë botën dhe gjithashtu i përkthyer në më shumë se shtatëmbëdhjetë gjuhë.

Teksa dihet tashmë se “Kandidati” i shkrimtarit Bucay, është një detektiv politik, romani i Çejkut ka një natyrë më fine, dhe rrethillet në këndin e tij të preferuar, sa politik, sa moral, sa social e sa përcaktues të fateve të përzgjedhura. Kur i pari mbetet një roman për luftën e popullit të një vendi të vogël për lirinë e tij, për zgjedhje të pavarura presidenciale, për një jetë normale dhe paqësore pa frikë për të ardhmen e tij, romani i Arben Çejkut shkon deri në labirinth të gjerave të prekshe. Por në thelb të dy kanë krijuar romane emocionues, thellësisht psikologjikë dhe interesantë. Romani i Arben Çejkut, madje mund të thuhet se është një roman alegorik me një prekje satire politike. Kështu Arben Çejku hyn pa frikë në rendin me shkrimtarët bashkëkohorë shqiptarë të afirmuar dhe të lexuar gjerësisht, dhe që mbetet premtes për fitimin e shumë çmimeve letrare.

E them këtë se më pëlqejnë romanet që fillojnë në mënyrë inteligjente dhe argëtuese, aq sa nuk e kupton kur ke lexuar 30 faqet e para. Më pëlqen edhe më shumë teknika e përshkrimit të personazheve kryesorë veçmas, Pajtim Karari, Qetsor Bubullima, Mimoza Lastari, Shepjetim Ngadalsimi, Trendafil Ferra, Qendrim Fluturaku, pastaj shtrembërimi i komplotit në mënyrë që ata të përfundojnë të lidhur në mënyrën më të papritur dhe të zgjuar.

Dhe tani, siç mund ta merrni me mend, Çejku i mbledh këta individë në një top intelektual marramendës të quajtur letërsi. Dhe prej saj, letërsi e mirë, me doza të mëdha ironie ndaj jetës publike në atdheun tonë të dashur. Kjo është arsyeja pse ishte e nevojshme të përdorëshin elementët e diskursit që përcakton kandidatin për kandidat. Diku me butësi, diku me mirësi, diku me pak dinakëri, sistemi bindi qytetarë të ndryshëm të përfshihen gati-gati pakuptimisht në veprën gjigante të përshtajës dhe vetëpërshtajës. Atyre iu dhanë mundësira dhe emra, atyre iu dha nga e padukshmja edhe vetë e dukshmja, të gjithë emra ose mbiemra, të cilët kishin për qëllim të ngatërronin destinacionin dhe të fshihnin identitetin e vërtetë të udhës nga ishin nisur. Megjithatë, objektet e tyre mbesin jo thjesht një kategori tjetër njerëzish. Këta mbesin më shpesh ata që nuk donin ta besonin plotësisht propagandën në shkallë të gjerë të procesit, në amulli të demokratizimit të gjerave dhe të vetvetes në grup.

Kjo është pikërisht ajo që bëjnë shkrimtari Arben Çejku në romanin e tij të ri “Kandidat për Kandidat” (Mediaprint, 2025). E njoh këtë autor në thellësi të penës së tij, në themel të talentit të tij, jo thjesht nga ajo që ka shkruar, por nga ajo që ka botuar, e nga ajo që mban të rezervuar për ta botuar. Më vjen mirë që talenti i Arben Çejkut vjen në kohën e duhur, dhe në pjekurinë e duhur. Kështu ky autor nuk është shkrimtari në këtë vepër, por dhe intelektual që ka bërë për vete një masë të madhe adhuresish të penës së tij.

“Kandidat për Kandidat” është një roman satirik që tall si kandidatët ashtu edhe sistemin, së bashku me shumë njerëz/rrethana të tjera tipike shqiptare, në një nivel të lartë, shumë të lartë intelektual dhe stilistik. Më pëlqeu shumë libri sepse ai qëllon

drejtpërdrejt atë pjesë të realitetit të shëmtuar shqiptar për të cilin mund të turpërohemi vetëm kolektivisht me kokën ulur. Me fjalë të tjera, “Kandidat për Kandidat” është një histori bashkëkohore relevante dhe e shkruar mirë. E lexova romanin me kënaqësi dhe mund të mendoj për të paktën disa njerëz të cilëve do t’ua rekomandoja. E admiroj thellësisht çdo lloj të tillë të letërsisë vendase cilësore që na kujton me dozën e duhur të humorit dhe parodisë se si ndodhin gjërat në këtë vend dhe pse ndonjëherë ne vetë jemi fajtorë për pasojat.

Satira, sikurse fantazia përtej satirës, ka qenë një shoqëruese e vazhdueshme e trillimit artistik. Sot është një karakteristikë e hipotezave të ndryshme, madje hyn dhe në skutat më të thukshme të shkencës, dhe shpesh e vetë zbulimeve shkencore dhe teknike, që reken të japin arsyet e veta me stile e art... Ne, bashkëkohësit e shekullit të 21-të, mund të jemi krenarë për këtë. Por jo shumë. Sepse satira dhe fantastikja kanë qenë gjithmonë një mjet universal për të shpjeguar të pashpjegueshmen (sigurisht, në nivelin e të menduarit shkencor të natyrshëm në secilën epokë). Imazhet fantastike të totemizmit, animizmit dhe antropomorfizmit u ofruan paraardhësve tanë të vetmin “model” të mundshëm dhe të kuptueshëm për shpjegimin e botës. Pasi imazhet mitologjike u tejkaluan si “shkencore”, ato mbetën si një burim i paçmuar i krijimtarisë artistike. E njëjta gjë ndodhi me demonologjinë e Mesjetës, me idetë e atëhershme rreth formës së Tokës, ose strukturës së universit. Alkimistët ishin në të vërtetë fantastikë vetëmohues, vetëm se nuk e dinin këtë... Satira kur ndërthuret tek fantazia, më shpesh quhet



sfera e konventës artistike. Kjo është e vërtetë, por është e pasaktë: është sfera e konventës satiro-fantastike. Sepse ekzistojnë dy lloje konventash artistike: realiste dhe fantastike. Dallimi midis tyre është në shkallën e probabilitetit dhe besueshmërisë. Specifika e trillimit artistik (në krahasim me trillimin shkencor popullor) mund të përcaktohet vetëm duke u nisur nga fakti se kjo është një specifikë artistike. Dhe kjo do të thotë: të vlerësosh fantastikën e satirës letrare jo vetëm në vetvete, por si një element (parim) të organizimit artistik të veprës. Këtë e bën mrekullisht pena e Arben Çejkut, po ashtu dhe ajo që ai e beson në tërë udhën e tij prej tre dekadash në politikë, diplomaci e në njohje të pandashme të vetë realitetit dhe strukturës së realitetit shqiptar.

Ndërsa “Kandidati” nga Jorge Bucaya mori Çmimin Letrar Spanjoll të qytetit të Torrevieja për romanin më të mirë në spanjisht, që sa i përket çmimeve, ai renditet i 3-ti pas Çmimit Nobel në Letërsi dhe Çmimit spanjoll “Planet”, dua gjithashtu të theksoj se “Kandidat për Kandidat” duhet të mbetet ndër titujt e nominuar për çmimin më të bukur të letërsisë shqiptare në kategorinë “Trillim Bashkëkohor Shqiptar” apo dhe më gjerë. Nëse do të ketë një adaptim filmik këtë herë, ende nuk dihet, por parashikoj sukses si për librin ashtu edhe për një adaptim të mundshëm filmik të tij.

POEZIA E ZYHDI DERVISHIT TREGON EKZISTENCËN NJERËZORE

Po i rikthehem një poezie. Po i ulem në ndjesi një vargu. Po lexoj... Titulli i përmbledhjes së poezive “Në Kryqin e Udhëkryqit” nga Zyhdi Dervishi shënon /jo/ një oksimoron ironik. “Mesazhi” kryesor, më duket mua, është kalimi i kohës dhe mrekullia e të bërit-në-qenie... Pa/fundi i përzhitjes, dhe përsëritja e stereotipeve klimaterike dhe njerëzore për “ëndrrat e mia përzhisin si zjarre” (“Kurban”; Pogradec, 16 gusht 2018), ndoshta i vetmi... Arketipi i ilaçit, i përmbysur përmes paradoksit “shpesh qiejt e trazuar të mendimit/m’i rëndojnë re të murme/stresi e mërzie” (“Ilaçi im”; Tiranë, 27 qershor 2018) – ngjyros botëkuptimin, kozmopolit në thelbin e tij. Nën këtë ombrellë stilistike letrare, poetike dhe tërësisht origjinale, perceptuese, është edhe vetë koha.

Koha, e realizuar përmes një gjeografie lokale, të cilën autori e vëren me kujdes. Në të njëjtën kohë, shpjegimet e udhërrëfyesit mungojnë, sepse kozmopoliti viziton qytetet, por jo si toponime, apo si pika gjeografike, apo shënime në ditarë historikë, por si hallka në një zinxhir ndjesish, aromash dhe pamjesh, të shikimeve të shkëmbyera, të specifikave të paharrueshme. Burimi i dëshpërimit dhe transit melankolik që fluturon në ajër është i fshehur nën “Gjethe Vjeshte” (po aty, faqe 124), origjina e tij është e zvetënuar, por paralajmëruese “Ma morën tokën e gjyshit/dhe më mashtruan me tapi/të shkruar në lëkurë gjarpri/të një trualli të lëruar/prej korbave” (ibid). Ashtu siç jeta e sotme është pa drejtim, libri i Zyhdi Dervishit,

nuk duhet lënë në harresë, nuk duhet zëvendësuar me kate poetësh, apo lexime librash nga institucione që me zor lexojnë e me zor dëgjojnë, sepse nuk dëshiron të na shpallë ndonjë të vërtetë supreme, megjithatë, në respektin e tij, na tregon më shumë për gjëra sesa për teori dhe diskurse të rënda “Në Kryqin e Udhëkryqit” të vetë dilemës njerëzore.

Duke skicuar siluetën e poetit me bojëra uji, libri na çon

intelektual profesional (Faqe 122).

Ai nuk vuan, por vuan poezia. Vuan letërsia. Duke shkatërruar klisheën se letërsia po vuan, kjo poezi na kthen në kohët e Safos duke shkuar përtej madje, tek “Virgjëri e blertë” (Faqe 93). Ajo gjithashtu rikthen dinjitetin e qëndrimit hyjnor të të gjithëve që qëndrojnë pranë poetit, duke shpallur një arkeologji të ndjenjave, siç është e natyrshme tek të gjithë



nëpër sallat e errëta të fateve të errëta ku vetëshkruhen e vetëlexohen “Vetëportretet në mjegull” (faqe 123), të cilat do të ishin të vdekura pa marrësin e tij, në fakt, janë pikërisht enët e lidhura të naivititetit të poetit dhe fëmijës që përmbajnë materien ku lulëzon poezia “Unë – një atom vetmitar/orbitës të skajshme/të nebulozës iki/pa kthim”. Sintezë, në vend të analizës, çiftëzimi kundër monedhës që fshihet pas asketit. Në fakt, në këtë rast, vetë poezia është një biografi; shkrim i lehtë, si apoteozë e jetesës së lehtë, sinqeritetit, thjeshtësisë dhe pastërtisë intelektuale, njerëzore dhe burërore, të atij që jeton me bulën e djersës, me përkushtimin adekuat dhe

ata për të cilët koha është një sasi lineare, madje edhe në përsëritjet ciklike të situatave, fytyrave dhe ëndrrave “Dua të çapitem/deri në mbrëmje/horizonteve të kësaj/virgjërie të blertë” (ibid). Forma e poezive është gjithashtu e lirë nga zburimet, nuk flirton me gjëgjëza, thjesht flet gjuhën në të cilën ndihet, flet me gjuhën e nënës, ashtu sikurse tek “Portret i trishtë i një nëne”:

“Para duarve të reshkura të nënës
përgjunjen malet
e gjithë krenarive
Para shikimit të turbulluar të nënës
verbohen yjet
e të gjitha yjësisë” (Faqe 31)

Magjia e nënës është më e respektueshme se vëzhgimi i fëmijës në diksursin me botën mbetet jo vetëm tek sytë e zemra, por tek vetë diskursi, sepse bota e nënës është tashmë sa abstrakte dhe aq e pasur. Dogma që është vendosur në mendimin letrar shqiptar se bota shqisore është më e pasur se abstraksioni i fjalëve has rezistencë, më duket mua, në përmbledhjen e poezive të Zyhdi Dervishit. Ndërsa e shkuara e sedërtuar

vargore gjoja na thirri përsëri te objektet, rezulton se vizionari i kohës moderne është më afër poezisë parësore, ndjenjës së injorancës rebele, frymëzuese para botës.

Pa dyshim, sot poezia e disa vëllimeve poetike të autorit sikurse “Në Kryqin e Udhëkryqit” (2019); “Mokra e Hijeve” (2014), “Vetëklonimi i Maskave” (2009),

““Jehonëlebetia” (2004) apo “Qiej të përthyer” (1999) po kërkon shtigje të reja dhe nuk dëshiron të mbetet në horizontet e mirazhit të shkrimtarëve të odave të tiranit.

Më duket se në fakt arti më naiv dhe autentik është të jesh i lirë. Kjo ndjesi krijohet dhe lexohet nga ky libër, i cili do të thoshim gjithashtu se është më shumë në rolin e intelektualit të heshtur me audiencën, dhe jo anasjelltas. Krijimi i botës është një proces i ndërsjellë. Kjo e qartësuar dhe e konkluduar tek poeti akademik Zyhdi Dervishi, sepse, pavarësisht dëshpërimit dhe deklarimit të dështimeve, kjo poezi është krijuese dhe pohon ekzistencën njerëzore.

ARSYET E “KËQIJA” NGA POZË- LEXIMI I KADARESË

Grupe-grupe, por më së shumti individë të “shkolluar” ngrejne një problem të diskutimeve dhe mendimeve që jepen nga disa për shkrimtarin Ismail Kadare, duke cituar se ata që flasin për Kadarenë, nuk e kanë lexuar atë. Unë nuk dua të gabo, të them të kundërtën, por në atë që ata shprehen, mendoj se e kanë për librat e shkrimtarit, jo për leximin e tij (leximi i tij ka kuptim ndryshe).

Në rininë tonë, ose më së shumti në ditët e shkollimit të brezit tim, në monizëm, nëse pyesje dikë pse duhet të lexosh Kadarenë, ndoshta do të të jepnin dy arsye: vepra e tij është e bukur, dhe na bën kërkesa, duke na shtyrë të mendojmë pak më fort, pak më thellë. Këto arsye mbeten të vërteta edhe sot. Por ka edhe dy arsye të këqija për të lexuar Kadarenë. Dhe, për fat të keq, janë këto arsye që po mbrojnë gjithnjë e më shumë sot vetë ata që thonë se e kanë lexuar Kadarenë, duke pozuar me shkrimtarin dhe ripozuar me komentet e tyre. Arsyeja “e keqe” numër një: Kadare është i mirë për aktivizimin e aktivitetit mitik për të nënkuptuar diktatorshipin. Kjo është e drejtë, disa akademikë kanë kryer të gjitha llojet e eksperimenteve të domosdoshme mbi leximin e Kadaresë - ata madje kanë dalë me një pjesë të mendimit se në tërësinë e kësaj strukture autori përdor një truk narrativ potencial të ndërlidhur me ngjarjet i ndryshimit funksional të narrativit në strukturën e fjalisë narrative. Duke vëzhguar sasinë dhe cilësinë e aktivitetit narrativ gjatë leximit të Kadaresë

në krahasim me shkrimtarët e tjerë, ajo që lexohet ndodh më shumë në këtë funksion kur njerëzit lexojnë si në funksionin “BARD”. Me sa duket, kjo ndodh sepse ai përdor fjalë në kombinime të pazakonta dhe të papritura.

Nuk është e nevojshme të jesh lexues i përqëndruar, apo ekspert letrar për të parë se ky këndvështrim

është banal në rastin më të mirë. Ka mënyra më të lehta dhe më të shpejta, jam i sigurt, për të rritur aktivitetin logjik nëse kjo është ajo që vërtet dëshirohet të bëhet.

Arsyeja “e keqe” numër dy: leximi i letërsisë së madhe mund të na bëjë njerëz më të mirë, më empatikë dhe më të dhembshur. Për shembull, psikologët David Comer Kidd dhe Emanuele Castano aplikuan “teknikat e teorisë së mendjes” për njerëzit që u ishin caktuar rastësisht libra të njohur dhe jo-fiction, ose klasikë letrarë. Ata ‘zbuluan’ se grupi i fundit ishte më i mirë në identifikimin e emocioneve tek të tjerët.

Kjo është një ide shumë vetë-lajkatore për ata prej nesh që pëlqejnë të lexojnë letërsinë me kuptimin e qartë për të bërë vend për veten me emrin e Tjetrit (Sa prej tyre shkruajnë me pathos e me superlativa, pa hyrë lexueshëm, qoftë edhe fare thjesht në tekst, në narrativ?!). Fatkeqësisht, thjesht nuk është e vërtetë. Në studimin Edukimi letrar: Një rivlerësim (1963), James Gribble argumentoi bindshëm kundër synimit, që letërsia të bën më empatik. Ai thekson se një korrespondencë e



drejtpërdrejtë midis asaj, se si ndihemi për personazhet kur lexojmë, dhe si ndihemi për njerëzit në jetën reale, injoron përpjekjet dhe talentet e shkrimtarëve. Është përmes artit të shkrimit të letërsisë që një shkrimtar mund ta bëjë të lehtë për ne të ndjejmë simpati për një personazh, të cilit, nëse i takojmë në jetën reale, mund të kemi vështirësi t'i japim kohën e ditës. Empatia dhe dhembshuria lindin nga një ndjenjë morale që kemi të gjithë, pavarësisht sa e pavarur mbetet nga çdo njohuri për letërsinë.

Një aspekt i rëndësishëm dhe i vlefshëm i leximit të letërsisë është se kërkon interpretimin e veprës. Kjo përfshin marrjen parasysh të formës objektive dhe përmbajtjes së subjektivitetit tonë. Aspekti i tillë përfshin marrjen e gjykimeve bazuar në interpretimet tona. Kjo aftësi për të interpretuar dhe kuptuar vetë, në vend që të marrim diçka si të dhënë, është diçka që mund ta sjellim në fusha të tjera të jetës, duke përfshirë përpjekjet e akademikëve për të justifikuar artin në termat e shkencës, ose virtytit moral. Nëse lejojmë që këto arsye të këqija

të dominojnë mënyrën se si ne e kuptojmë dhe justifikojmë leximin e Kadaresë, ne shkojmë kundër trukimit të tij të thellë në përdorimin e miteve.

Kjo sepse, përdorimi i mitit në letërsinë narrative është thelbësor. Ky përdorim i thellë i Kadaresë, ofron një burim të pasur temash universale, arketipesh dhe gjuhe simbolike që rezonojnë thellë me lexuesit. Kadare sikurse dihet eksploron përvojat komplekse njerëzore dhe strukturat shoqërore në një mënyrë kuptimplote. Mitet e tij tek “Konkurs bukurie në Bjeshkët e Namuna” apo “Sjellësi i fatkeqësisë”, dhe jo vetëm, ofrojnë një kornizë për të kuptuar veten, vendin tonë në botë dhe marrëdhëniet tona me të tjerët, duke i bërë ato mjete të fuqishme për zhvillimin e personazheve, ndërtimin e komplotit dhe eksplorimin tematik. Ja pra pse arsyet e “këqija” për të lexuar Kadarenë mbeten tek ata që shkruajnë nga mosleximi i veprës së tij. Mosleximi, ose leximi duke pozuar e publikuar komente pos pozave, krijojnë hendekun e të gjithë këtij problemi.

PAS NJË FOTOGRAFIE NGA KANADAJA

Shkurt, bota është bërë një xhungël, ku të gjithë jemi nxituar drejt “të panjohurës”, të ngatërruar në hardhitë e ashpra të rregullave të padukshme. Me ne, nga rrënja në majë, si gjethe të zhytura në pluhur dhe kalbje, kulturat tona vendase, shkrumbohen, rëndojnë dhe rrëzohen. Në betejën e madhe për mbijetesë dhe rritje, kjo larmi e bukur traditash dhe gjuhësh, besimesh dhe mentaliteti familjar, bien në mënyrë të pashmangshme në vjeshtën e hershme të zhdukjes globale. Lart, drejt yllit të zjarrtë të suksesit, shpresat tona të pashpresa mbeten. Të gjitha fërshellejnë në mënyrë të barabartë në thatësinë e besnikërisë së tyre ndaj depersonalizimit. Dhe pastaj shndërrohen në pluhur, të shtypura nën sulmin e veprave të reja arrogante.

Ajo që ka ndodhur është fakt. Ikjet, r i v e n d o s j e t , p ë r k u s h t i m e t integruese janë bërë një art më vete. Një art që rikthen bashkë, miq e të njohur, shkë e të afër të afërt e të largët, por që kanë një gjeografi të përbashkët. E gjithë lëvizëse. E gjithë mirëkuptuese. Një ushtrim mbijetese globale ose si tradita elbasanase fiton të drejtën e rikujtesës të vet në hapësirë tjetër, në hapësirë të blertë. Por sidoqoftë le të hyjmë në temë. Me këtë rast le të prezantojmë për “protagonistët” e asaj që dua të shpeh...

Është një mjedis në Kanada. Është një hapësirë e blertë, e pastër me miq e shokë të sinqertë. E në këtë shkrepje dixhitale janë: Nga e djathta, Ardjan Graceni Benin Lopari, Lul Qendro, Kastriot Vinçani, Kujtim Kaloti, Cen Dervishhasani, Bert Kazazi. Pastaj, majtas, Pavlo Jano, Arben Burburija, Qemal Kurti, Kol Bace, Agim Hoxha, 2 te tjetër jane miq, pastaj, Nipi i

Demir Hoxhës, Arjan Subashi, Lefter Paço, dhe realizuesi i kësaj fotografie Cen Dakli.

Në fakt në një “kërthizë” të tillë të improvizuar “Shqipërie të Vogël” në Kanada, janë bërë bashkë me miqtë e organizatorët elbasanas, tërë viset shqiptare, gjithë qytetet shqiptare, gjithë gjeografia shqiptare, që në bisedën e lirë del se i ka rrënjët dhe lidhjet elbasanase anekënd. Dhe shkurt kryefjala Gjuha Shqipe e pastër, e bukur dhe popullorçja e sinqertë, që ngre dolli në këtë mjedis të blertë.

E mes kësaj gjuhe, e gjitha që shpërndahet në rrjetet sociale, me teknologjinë e kohës, i

politisht për Elbasanin edhe në politikë. E kështu të gjithë me radhë, që nga Koli i artit dhe televizionit e deri tek Qemali i gjithëpërfshirjes dhe Prefekturës së Elbasanit. Të gjithë me një fjalë të thejshtë që mbetet Kryefjalë, natyrisht nën simbolikën me tryezën plotë, mish të pjekur, raki tradicionale ... plotë në zemra e mjaft krenar.

Pas këtij mesazhi të bukur për brezat, për të gjithë në fakt, vetë të shkruarit rrëshqet dhe diku e ka një merak. Si gjithmonë, diçka e errët dhe primitive ngrihet fuqishëm në të gjithë qenien lëvizëse shqiptare. Si një filiz, që shpon

gjithashtu, pikësimi, ai brez kufitar i gjuhës së shkruar, ku është sot, i rrëmbyer në anarkinë e pandërprerë të fjalëve, i kryqëzuar me pendët barbare të fjalëve të emigrantëve?

I kapur në pasionin e nxehtë të monologut, shtroj penën time sinqerisht me një koment se bashkëfolësit e mi elbasanas janë gjithashtu të shqetësuar për fshirjen e asaj që ndodh në gjuhën time amtare, se rregullat po zhduken nën bykun e mesazheve celulare dhe se koha globale po e sheston gjuhën e bukur të gjysheve e gjyshërve tanë.

Dikush është i shtangur. Hutimi i ngurtësuar në fytyrën e tij kufizohet me kretinizmin:

- Elbasançe? A ka ndryshim kjo gjuhë?

Në një çast të shkurtër, e kuptoj se në ushtrimin e mbijetesës globale, gjithë duhet të bëhet grabitqar!

Prandaj, rënkoj, duke shkelur lëkurën e qengjit që piqet në hell, duke u ndjer komod nën përkujdesjen e mikut tim të hershëm Ben Burburisë, midis copave të qymyrit kanadez që digjet dhe cirkëkryengrytësve të paturpshëm të zjarrit që të djeg:

- Ja ku është, koleg i dashur! Meqenëse elbasançja është gjuha shqipe, furnitorja më e vjetër e e gjuhës së folur e të pasuruar, ushqimi i saj është vetëm një rruazë e vogël në pasurinë e saj të pamasë. Pikë.

Dhe u ndërpresa të shkruarën time frymëzuar nga ky rast. Një monolog i shpërthyer mbeti pas meje, si një vrimë në një libër shkollor antik, i dëmtuar në luftën e globalizimit. E nesërmja është thjesht një mesazh, një email i sjellshëm nga Kanadaja duke më shtuar respektin për këta intelektualë që i mungojnë Elbasanit, Shqipërisë sonë të dashur. Por kanë ende traditën e një Shqipërie të Vogël me vete, janë mesazhierët e shenjtë të kësaj bukurie tradicionale.



jep dhe një mesazh tjetër të qartë e të bukur Botës. Të gjithë duan të mësojnë diçka rreth identitetit të tyre të ri të shartuar dhe me zell shqiptari thithin çdo hir verbal që ka ngatërruar ajrin në një rrjetë të vjetër, migratore, por që krenarinë e shpalosin hapur e qetë, ashtu në një mjedis burror të thjeshtë, disi patroarkal, por të shëndetshëm e identitar për një mesazh të bukur në rrjetin social. Natyrshëm Beni, ai që diti dhe të përkushtohet në fillimet e bukura e shpresëdhënëse të Demokracisë me PR e Elbasanit, tani pa frikë e thotë se është krenar që bëri aq sa mundi intelektualisht dhe

një copë balte, i butë dhe i paturpshëm, i etur për jetën e vet, për hapësirën e vet. Për liri.

Askush nuk guxon ta ndërpresë kryerendësin e bisedës, i cili është bërë model në përpjekjen e tij për të na bindur se sa e trishtueshme është që mërgimtarët e sotëm nuk e shqiptojnë fjalën e hershme tradicionale elbasanase, që ushqueu në shekuj dialektet, por tërhiqen nga një përtypje plebejane e aristokracisë fonetike të lënë trashëgim nga paraardhësit e tyre duke u shkrirë e tretur tashmë në dheun tjetër dhe në absurditete të tjera. Dhe

MISH HALLALL DHE TË KONTROLLUAR

Supermarketi Hilal Food Centre në High Kilburn Road, si mjaft të tjerë supermarkete në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar shërben mish hallall prej të gjithë kohëekzistencës së tij. Po çfarë është "Halal"? Në arabisht, fjala Halal do të thotë "e lejuar" ose "e ligjshme" dhe përcakton çdo gjë që është e lejuar ose e ligjshme sipas Kuranit. Shpesh përdoret në kontekstin e ushqimit

- veçanërisht mishit - për të treguar se ushqimi është përgatitur në përputhje me parimet dhe teknikat myslimane. Ligji i BE-së kërkon që kafshët për zinxhirin ushqimor të trullosen (të lihen pa ndjenja) para vrasjes, në mënyrë që vdekja të jetë pa dhimbje, megjithëse ekziston një përjashtim për therjen fetare.

Megjithatë, shumë restorante ende kërkojnë që therja Halal të përfshijë trullrosjen e parë, dhe shumica e therjes Halal në Mbretërinë e Bashkuar përfshin trullrosjen sipas RSPCA-së. Një raport nga organizata

bamirëse e kafshëve në vitin 2012 thotë se 90% e deleve dhe 97% e bagëtive të therura duke përdorur metoda Halal në Mbretërinë e Bashkuar u trullrosën së pari.

Një nga punonjësit e këtij supermarketi na tha: "Ne kërkojmë që të gjitha proceset e therjes për produktet me markën e supermarketit të përmbushin kërkesat tona të rrepta për mirëqenien e kafshëve, pa përjashtim. Në çdo rast, ne shesim

mish të markës, ose presim koncesione që shesin mish hallall të pa trullrosur. Kjo është për t'i shërbyer klientëve që dëshirojnë posaçërisht të blejnë mish të pa trullrosur. Ky mish është etiketuar qartë si Halal, në mënyrë që klientët tanë të jenë në gjendje të bëjnë zgjedhje të informuara. Mishi hallall preferohet për disa arsye, duke përfshirë rëndësinë fetare, konsideratat

mbi arsyet e preferencës së mishit hallall:

1. Rëndësia Fetare:

Ligjet Islame të të ngrënit:

Mishi hallall është një pjesë thelbësore e ligjeve islame të të ngrënit (Sheriati), i cili dikton se çfarë është e lejueshme për konsum.

Kuptimi Simbolik:

Konsumimi i mishit hallall shihet si një mënyrë për të ndjekur urdhërimet e Zotit

duke reflektuar vlerat islame të mirësisë dhe dhembshurisë.

Pa Vuajtje të Panevojshme:

Praktikat hallall synojnë të shmangin dëmin e panevojshëm dhe të sigurojnë që kafsha të jetë në një gjendje të shëndetshme para therjes.

3. Përfitimet e perceptuara shëndetësore:

Pastërtia dhe freskia:

Kullimi i plotë i gjakut gjatë therjes hallall mendohet se e

bën mishin më të pastër dhe më të freskët, me më pak konservues ose aditivë të nevojshëm.

Hormone të reduktuara të stresit:

Disa besojnë se procesi i therjes hallall, i cili shpesh shihet si më pak stresues për kafshën, çon në mish që është më i butë dhe më pak i fortë.

Pa hormone dhe pa antibiotikë:

Mishi hallall shpesh rritet pa përdorimin e hormoneve të rritjes ose antibiotikëve, gjë që mund të jetë shqetësuese për disa konsumatorë.

4. Faktorë të tjerë:

Certifikimi:

Mishi hallall shpesh certifikohet nga organizata me reputacion, gjë që i siguron konsumatorët se përmbush standardet dhe udhëzimet e kërkuara.

Disponueshmëria:

Mishi hallall po bëhet gjithnjë e më i disponueshëm në supermarkete, restorante dhe institucione të tjera ushqimore, duke i shërbyer një audience më të gjerë.

Shija dhe tekstura:

Disa njerëz e gjejnë mishin hallall të ketë një profil të dallueshëm shijeje, shpesh të përshkruar si më i butë dhe më i pastër se mishi konvencional.



HILAL FOOD CENTRE

MISH I KONTROLLUAR DHE



KUALITET

etike dhe përfitimet e perceptuara shëndetësore. Për myslimanët, është një kërkesë fetare dhe konsiderohet gjithashtu një opsion më human dhe etik, me udhëzime që sigurojnë që kafshët të trajtohen me respekt para therjes. Përveç kësaj, procesi i therjes hallall, i cili përfshin kullimin e plotë të gjakut të kafshës, besohet se kontribuon në mish më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Ja një vështrim më i detajuar

dhe për të demonstruar devotshmëri.

2. Konsiderata Etike:

Trajtim Human i Kafshëve:

Praktikat e therjes hallall janë të dizajnuara për të minimizuar dhimbjen dhe vuajtjet për kafshën, shpesh të konsideruara si një qasje më etike sesa metodat konvencionale.

Dinjteti dhe Respekti:

Procesi thekson trajtimin e kafshës me respekt dhe dinjtet, madje edhe në vdekje,



46 BIRCHINGTON ROAD
NW6 4LJ

Restoranti I SHQIPTAREVE

Restaurant Bar "Imperial"

"Shijoni shijet e pjatave tona të shkëlqyera, ku çdo
kafshatë tregon një histori të shijshme."



Kualitet

Dasma

Ne ju ndihmojmë në
perfeksion



Cilësi

Festime

Ju a bëjmë më festive
festën tuaj



Pastërti

Familjare

Ne jemi si një familje
ndaj e dimë
familjaren

Rezervo



020 7624 1385

EDUART BALA: PROFESIONALIZMI PËR DËRGESAT TUAJA

Ju njoftojmë se kompania që drejtohet nga Mondì, që është dhe mbetet kompania më e sigurtë dhe më profesionale e transportit të mallrave nga Anglia drejt Shqipërisë dhe anasjelltas, do të kryejë destinacionin e saj përkatës të radhës duke grumbulluar mallrat në datën 26 tetor 2023 në këto qytete britanike: Birmingham, Luton, Banbury, Oxford, Coventry, Northampton, Manchester, Leeds, Sheffield. Po ashtu ju njoftojmë se nisja e destinacionit përkatës nga Shqipëria drejt Anglisë bëhet në datën 5 Nëntor 2023. Për më shumë informacion kontaktoni drejtuesit e kësaj kompanie në celularin që jepet në fund të këtij shkrimi.

Mjaft kompani transporti e nisin me një slogan sikur janë qindra vjeçarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania që drejtohet nga Eduard Bala (Mondì) mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti i destinuar mbetet prioriteti dhe profesionalizmi, besimi dhe konsiderata efikase.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të tjerë të lidhur me Atdeun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të

eksperiencia e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet

standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbetet qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja.

Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente, kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë kjo është zgjedhja e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë.

Me këtë transport, e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Duhet theksuar se mbi 50kg i marrin dhe i dërgojnë në destinacion.

Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet



SHPEJT
SAKTË - RESPEKT

BEST PRICE!

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHIQIPËRI & SHIQIPËRI-ANGLI

Mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion.

- **ANGLI:**
- +447395287400
- **SHIQIPËRI:**
- +355 68 3676859

VLERA PROFESIONALE

SAKTËSI - KURSIM

RESPEKTI NDAJ KLIENTIT
NA PROVONI



Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

investorë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh në Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duam të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga

konkurrese dhe në çmime.

Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në WhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e

TRANSPORT MALLRASH:
ANGLI-SHIQIPËRI &
SHIQIPËRI-ANGLI

ANGLI: +447395287400

SHIQIPËRI: +355 68 3676859

E PAVDEKSHMJA BEJKË E BARDHË

(UDHËTIME NARRATIVE TË VOGLA PËR DASHURINË E MADHE)

Pesëdhjetë e dy vjet më parë, një grup i veshur me kostumin tradicional të Pilurit ecte në rrugën e gurtë të qytetit të Gjirokastrës. Djaloshar, atëmoshë, e ndoqa në sallën e vetme të TV-së publike të kohës, mes disa të tjerëve bashkëmohatarë. Mes tyre ndiqja dhe një heshtje protagonist. Vitet më pas më treguan gjerë e gjerë për Lefter Çipën. Asokohe, syri im bënte detyrën që mund të bëjë një sy, natyrisht në kuptimin e fiksimit të detajeve. E ndoqa në thembra, i goditur nga ecja e figurës së tij të hollë, të shtrirë mes hijeve të tjera si një trup energjik, i endur nga qëndisje e ndjeshme. Pastaj ndjeva se çfarë do të thoshte të “shkelje mbi avull” dhe, i ndezur nga muzika atavike e gjakut, të kërceja si një dhëndër para dasmës gjithëpërfshirëse me jetë. Shumë më vonë, kuptova se atëherë e kisha bërë dashurinë time të parë të ngulitur në themelet e kujtesës. Ngjyrat e zjarra të atij festivali të largët folklorik përpinë në mënyrë të pakthyeshme pasionin tim pesëminutësh për të largëtin, që printe grupin, për atë që i kishte dhënë nga shpirti jetë kompozimit të “Bejkës së Bardhë”. Isha vetëm disa vite mbi fletoren që bënte Detyrat e Shtëpisë me vizë të kuqe anash dhe nuk kisha idenë se në ritmin e pabarabartë të poezisë sime të mëvonshme, prozaïke, kisha ngulitur një depërtim në përkatësinë time të pashërueshme ndaj të mive..., të afërt e të largët, por të mjalët në atë që u ndje edhe pak ditë më parë me edicionin e gjashtë të festivalit folklorik “Netët e Bejkës Bardhë”.

Është kështu padyshim rryma e padukshme e jetës që na lidh së bashku në një rruzare njerëzore, duke përhapur qarqet e saj stërgjyshore nëpër kohë dhe kontinente me timbrin dhe ritmin e 18 grupeve konkurrese dhe përshëndetëse me rreth

200 artistë amatorë dhe profesionistë dhe padyshim me Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve si një dedikim të veçantë për përkushtimin, gadishmërinë, por mbi të gjitha për përjetësimin e këngëve dhe valleve të Pilurit!

Në logjikën natyrore të ekzistencës, e cila na transformon nga trashëgimtarë në paraardhës. Në mënyrë që ata që vijnë pas nesh të mësojnë nga hapat tanë, sepse nuk ka asgjë tjetër për të lënë pas, përveç kuriozitetit për botën dhe ëndrrës për të udhëhequr traditën e bukur me “Netët e Bejkës Bardhë” në drejtimin e mjeshtrit Kristo Çipa, me një tonalitet sa poetik, folklorik, ideal, personal dhe të suksesshëm.

Gjithmonë kam dashur të lexoj një fotografi të një kostumi popullor të tillë, të bukur, të papërsëritshëm, të rrënjësor në folklor dhe tradita dhe kur ai vishet nga 200 artistë rreth gjysma artistë të rinj dhe të tjerët të ritur e moshuar nëpër skena si Golik Jaupi, Milto Gjiçali, grupi i Dukatit, Leni Mërkuri, 10 Shqiponjat e Tërbaçit, Guriu i Mallakstrës etj. Natyrisht mesha e mesazhit ka pak fjalë, por mbetet e radhë: Ky do të jetë një dokument i identitetit tim. Thirrja e këtij mesazhi vjen nga vitet: Ejani në “Netët e Bejkës Bardhë” në Pilur dhe ndoshta do të mësoni diçka të re edhe për veten tuaj, pavarësisht se nga cila krahinë, apo zonë jeni ... Dhe kjo ndodh natyrshëm kur shoh se përkrah Milto Gjiçalit që i bie dajres, është brezi më i ri, pra është Niko nipi i tij, që përveç ankthit të motiveve baritore, kapërcen edhe ledhin e thatë të opinionit të moshës.

Organizatori i palodhur na vjen në ndihmë me këtë rast të mësojmë se “U interpretuan rreth 70 numra me këngë e valle të cilat sivjet ishin me shumë cilësi, pati edhe disa

tendenca të izoluara për të rikthyer në skena në emër të moshës së krijimit edhe këngë me karakter religjioz që u zbehën si hiri kur digjet letra.”

Nuk mund ta besoj që në zemër të të Rivierës Shqiptare në qarkun Vlorë, Shqipëri, ku vlon terminologjia turizëm, e nxehta dhe vapa sa mediatike dhe natyrore të mbetet vetëm një pikë, që duhej të ishte kryefjalë. Kjo pikë kulturore e madhe është pjesë e bashkisë Himarë. Nuk është thjesht nën emrin Pilur. Nuk e ka vetëm fshati..., as vetëm se fshati Pilur ndodhet në Shqipëri, por aty në atë pië-kryefjalë është Jug e Veri, është gjithë Rruzulli mbarë, ku ka e ku s’ka shqiptarë. Se jo thjesht është një Festival, por është i pavdekshmi “Netët e Bejkës Bardhë”.

E them këtë se ai është kumbues, i inkurajuar nga një dashuri kaq e fortë dhe besnike! Këtu, në një seri gëzimesh, hidhërimesh, grindjesh dhe pajtimesh, tingëllon shpirti i gjithëgjendshëm i gadishullit. Orkestra i transformon me tension ritmet primordiale në lëvizje, në kontakt të botëve që kërkojnë veçanti, në kundërshtim me ndëshkimin modern. Folklori i tillë është kryesisht një bashkësi e lashtë sa vetë ekzistenca, e mbushur me një prani tipologjike që flet dhe të sjell hare, gëzim, ndjesi dhe të qeshura të sinqerta edhe nga shtëpia. Nuk ka kufizime moshe. Në fakt, nuk ka fare kufizime, sepse të gjitha moshat dhe gjuhët, fatet dhe sprovat, që vërtiten në dëshirën për të qenë së bashku, dorë për dorë, në hapa sulmues kundër vetmisë, alienimit dhe madje edhe vdekjes, derdhen në valën energjike të folklorit të bukur e të mirëorganizuar. Ato bashkohen nga vitaliteti vullkanik i muzikës tradicionale, emocioni paraverbal i pasioneve të përjetshme njerëzore, i shprehur në ritëm dhe këngë, dimension sa



personal dhe universal deri në pafundësi. Fenomeni i këtij evenimenti, pra i “Netët e Bejkës Bardhë” për sa i përket përzemërsisë qëndron në mungesën e ambicieve për fitore skenike, por ai i meriton të gjitha. Dëshira e zemrave në fakt shkon dhe tek ky fakt meitor, që për të cilin Kristo Çipa na vjen në ndihmë: “Konkurenca ishte e lartë dhe juria nga më profesionale të fushës e folklorit me shumë mënjori e barazi dha këto vlerësime: Çmimi i parë “Lefter Çipa” i jepet grupit “Saranda”. Çmimi i dytë “Maliq Lila” i jepet grupit të Dukatit. Çmimi i dytë “Maliq Lila” i jepet grupit “Djemtë e Bogonicës (urime dhe vazhdimësi)”. Çmimi i tretë “Feti Brahimi” ju dha grupit të fë rinjve të Delvinës. Çmimi i tretë “Feti Brahimi” ju dha grupit “Djemtë e lumit bardhë”. Çmimi special “Haxhi Dalipi” ju dha grupit legjendë të Bënçës. Çmimi vlerësues ju dha grupit “Nektari i polifonisë”. U dhanë edhe çmimet individuale. Marrësit më të mirë me titujt: “Dhimitër Varfi” Vendim Zyko, “Ermioni Mërkuri” Behije Dida. Kthyesit më të mirë me titullin: “Qirjako Bala” dy artistë Viron Laçaj, Shpresa Kapo Çela. Hedhësit më të mirë me titullin: “Leni Mërkuri” dy artistë: Fatmir Tahiraj dhe Kapo Ferrunaj. Çmimi i parë pati edhe një vlerësim prej 1000 eurosh, vënë në dispozicion nga presidenti i “Rexhina grup” zoti Vasil Bedinaj ndaj të cilit gjej rastin të bëj një falënderim publik më emrin tim personal, Asambli folklorik “Bejkë e Bardhë”, të banorëve të fshatit Pilur.”

“AG SHOW”, NJË PERLË E DIVËS EMËRMADHE SHQIPTARE

Të vendosur në kushte mbingarkese sociale për shkak të shumë faktorëve, deri tek emigrimi, kundërveprimi i të cilëve na privon nga shumë gjëra të zakonshme për hir të mbingarkesës sonë, ne domosdoshmërisht vërtetojmë brishtësinë e jetës njerëzore dhe fillojmë të pyesim veten: “Çfarë mbetet pas nesh?”, “Kush jemi ne?” dhe “Për çfarë do të kujtohem?” Këto janë pyetjet që i bëjmë vetes kur shikojmë prapa dhe shohim vitet e kaluara të jetës sonë. Të provokuar nga natyra e jashtëzakonshme e situatës, jemi të befazuar kur zbulojmë se deri më tani nuk i kemi bërë vetes pyetje të tilla, të cilat në të vërtetë përbëjnë personalitetin dhe identitetin tonë, duke i dhënë kuptim ekzistencës sonë në kohë dhe hapësirë. Nëse pranojmë që muzika është jeta jonë, duhet të përqijemi t’u ofrojmë përgjigje të paktën disa prej pyetjeve të parashtruara, që rendin sa tek muzika, aq dhe tek trashëgimia muzikore, që do ta cekim më poshtë.

Kush “bën” muzikë?

Përgjigja e shkurtër për këtë pyetje është muzikantët dhe njerëzit që janë të përfshirë profesionalisht në krijimin dhe mësimdhënien e muzikës në nivele të ndryshme arsimore. Gjithashtu zbulon identitetin profesional të autorit të tekstit, por si çdo përgjigje e shkurtër, ngre pyetje shtesë. Çfarë (për shembull) duhet të kuptojmë kur përdorim konceptin e përgjithshëm të “muzikantit” tek trashëgimia muzikore?

Trashëgimia muzikore shqyrtohet me kuptimin se ajo që është arritur nga brezat e mëparshëm është një kujtesë me të cilën ne masim veten dhe dallohem për të shprehur veten në forma muzikore përmes të cilave pasurojmë dhe zhvillojmë kulturën muzikore të shoqërisë. Për më tepër, kreativiteti muzikor

që kemi demonstruar mund të kuptohet dhe vlerësohet saktë si një kontribut.

Pra çfarë është trashëgimia muzikore?

Historia njerëzore tregon se të gjitha brezat kanë nevojë për trashëgiminë e tyre. Quhet edhe kujtesë stërgjyshore, histori, kulturë. E gjithë kjo është e nevojshme për njerëzit, sepse paralelisht me transmetimin e njohurive dhe traditave të brezave ardhshëm, ata ruajnë edhe një pjesë të vetes. Pse është e rëndësishme t’u mësojmë fëmijëve të vlerësojnë, ruajnë dhe transmetojnë trashëgiminë e tyre? Kjo pyetje do të kërkojë përgjigje që janë objekt dhe subjekt i këtij studimi. Trashëgimia muzikore është një objekt specifik brenda fushëveprimit dhe përmbajtjes së konceptit të përgjithshëm të trashëgimisë kulturore. Në këtë drejtim, do të shqyrtohen rregulloret ligjore dhe metodat e ruajtjes së trashëgimisë muzikore. Është e habitshme që Akti i Trashëgimisë Kulturore nuk përmban një përkufizim të saktë që do të dallonte atë që është e ndryshme dhe specifike në lidhje me trashëgiminë muzikore nga pjesa tjetër e trashëgimisë në fushën e kulturës. Kjo mund të jetë për shkak se ligjvënës në ishin specialistë në fushën e artit muzikor dhe për këtë arsye nuk u përpoqën ta përcaktonin trashëgiminë muzikore si një kategori të veçantë të trashëgimisë kulturore. Nuk ka një përkufizim të qartë që do të tregonte se çfarë saktësisht kuptohet dhe përfshihet në trashëgiminë muzikore, sepse muzika, këngët dhe vallet si pjesë e trashëgimisë kulturore janë koncepte shumë të përgjithshme. Muzika është një nga shtatë artet e njohura, e klasifikuar si art kohor dhe në kundërshtim me artet hapësinore (siç janë artet pamore dhe arkitektura), dhe

këngët dhe vallet janë zhanre të artit muzikor.

Ky shkrim paraqet trashëgiminë muzikore si pjesë të kujtesës, historisë dhe kulturës muzikore të shoqërisë mes emisionit “AG SHOW” të Aurela Gaçes në “Top Channel”. Kjo, jo vetëm në kontekstin e trashëgimisë dhe kulturës muzikore, por më tej, se çdo të premte, ora 21:00 në “Top Channel” ka bërë që shqiptarët të mbesin me zemër e sy tek “AG SHOW”. “AG SHOW”, tashmë ka hyrë në skenën televizive shqiptare, si një e premte e shumëpritur. Puntatat e Aurela Gaçes, këngëtares shqiptare me emër të madh, e kanë bërë këtë risi të bëhet risi dashurish me ekranin e televizionit që e shfaq atë. Në muzikë, “puntata”, ky term italian, zakonisht i referohet një forme, ose strukture specifike muzikore, dhe përdorimi i saj varet nga konteksti, që në këtë rast e bën “AG SHOW”-un një nga format më të dashura deri më sot. Sikurse dihet “puntata” më së shpeshti shoqërohet me termin italian për “episod”, ose “episode”, por përdorimi dhe kuptimi i saj tek “AG SHOW” mbetet në varësi të pjesës specifike muzikore, ose periudhës muzikore.

“AG SHOW”, sipas këtij skenari është një koncept unik i -t të përgatitur me mjaft profesionalizëm nga Aurela Gaçe. Tek “AG SHOW” gërshetohet muzika LIVE. Aty dallon performanca skenike e jashtëzakonshme. Tek “AG SHOW” për herë të parë, publiku në sallë mbetet i përfshirë në skenë përmes surprizave, të ftuarve, lojërave, humorit dhe artit të fjalës.

Autorët e “AG SHOW” janë



Ervin Kurti, Lorina Mixha dhe Regjisor: Redi Treni.

Puntata e parë ishte titulluar “Miqësia”. Të ftuar në këtë episod ishin: 1. Aleksandër Gjoka- Kantautor 2. Elton Deda – Kantautor 3. Redon Makashi- Kantautor 4. Dashnor Diko- Këngëtar 5. Adhurim Demiri- Këngëtar 6. Ledina Çelo- Këngëtare 7. Nik Zaimi – Këngëtar 8. Edea Demaliaj – Këngëtare.

Puntata e dytë kishte një emër mjaft domethënës “Gjuha e nënës-Emigracioni”. Të ftuar ishin: 1. Kastriot Çausi – Aktor. 2. Eli Fara – Këngëtare. 3. Vitori Balili – Këngëtare. 4. Grupi “Muza polifonike”. 5. Megi Pojani – Moderatore. 6. Ismail & Gjetan Keta – Boksierë. 7. Ansambli “Hakis Ndreu”. 8. Gëzim Nika – Këngëtar. 9. Olen Cesari – Violinist.

Për të lexuar shkrimin e plotë online, hapni kamerën e telefonit, drejtojeni nga kodi QR dhe klikoni mbi lidhjen që shfaqet për të vizituar www.fjalaelire.com dhe revistën “Albanian Post”.





Divele

Food Centre

Supermarketi jonë është një vend i përsosur për të gjetur ushqimin tuaj të preferuar shqiptar! Ne përdorim vetëm burimet konkurruese për të siguruar cilësinë e shportës sonë.



Oferta speciale dhe çmime konkurruese



MERRENI PRODUKTIN SHQIPTAR ORIGINAL!



151-155 BALLARDS LN, CHURCH
END, LONDON N3 1LJ



SALMAN ŞIRINGÜL

Arya

SUPERMARKET



Design: www.fjalaelire.com



159-160, Parrock Street, Gravesend,
England, DA12 1ER

SHUMËKUSH MUND TË PIKËTA KOJ VETVETEN, NË TË TILLA RASTE, KUR NDJEK “RRUGËTIMI IM” NGA MERO BAZE

Një pluhur i tistë, i dukshëm dhe i padukshëm, godet hapësirën që herë vjen e gjelbërt e herë e grimuar nën fokusin e kameramit të televizionit shqiptar. Skenari është i thjeshtë dhe kameramani e ka objektivin e qartë. Koha rrëshqet në histori dhe mall dhe fjala përmbushet me respekt të paparë. Disa figura, të njohura e të panjohura në lëvizjen dhe zhurmën e vazhdueshme, fytyrat e rrudhura nga memorja, distancat e shkëlmuara dhe aroma ndërhyrëse e vazhdueshme e zbrazëtisë, e ndiqnin me kërkshëri dhe këmbëngulje hapin e protagonistit. Ai e urren vetminë, por nuk e adhuron as kaosin. Shqisat e tij po përshtaten me detyrimin për të qenë vazhdimisht vigjilent dhe për të skanuar me kujdes çdo kornizë lëvizjeje në këtë rrugëtim, të përhumur në turmën kohore, më shumë se sa në ekzistencën dhe mbijetesën njerëzore. Të mbajturit mend lëvizin pa dallim. Të gjithë nga kudo. Secili përçark njëri-tjetrit. Të palëkundur. Dashamirë. Vazhdimisht. Një rreth vicioz i pafund, fshirës dhe memorjeverasës nëse devijohesh vetëm për një çast nga ajo që të mban memorjen dhe kujtimet gjallë, për t'i shpëtuar kurthit të kohës dhe për të mbijetuar të gjitha ato që mund të mbeten si perla për brezat.

Në përhumbe të ekranit. Kaq ishte. Më vonë, mund të kujtoje edhe kush ishte, nga vije dhe pse përfundove këtu, edhe pa qenë aty, sepse ekranit dhe siglat e tij të përpinin. Mendim pas mendimi dhe fjalë pas fjale, për t'u mbledhur në qenien njerëzore që ishte dhe që do të doje të ishte përsëri, pra si Ai, protagonist... Emri. Mbiemri. Emri i familjes. Moshë dhe gjinia. Statusi shoqëror. Interesat... Shpirti dhe materia në gëzimin e egër të shansit për të ekzistuar pak më gjatë.

Dhe vetëm kaq. Kaq mjafton të përshkruash më qartë ... Ti po ndjek një emision dhe ndoshta nuk je në mision. Por ja që një emision, ndonjëherë të delegon të përfshiresh edhe vetë në një mision...

Në një emision të shkëlqyer të RTSH-së ndoqa nën titullin “Rrugëtimi im” një nga figurat e gazetarisë së sotme shqiptare, Mero Baze, që është dhe botues i gazetës “Tema”. Në thelb dukej sikur të ishte thjesht kthimi te rrënjët në Peshtan dhe dëshmia për krijimin e PD Mat, që në fakt ishte vetë itinerari i memorjes Baze tek “Rrugëtimi im”, ai që shkante nga moshë femërore, që ishte rrethuar me moshën e tretë, dhe nën përkujdesjen e gjyshit, deri tek dalja në jetë si inxhinier i Gjeologjisë shqiptare të para viteve nëntëdhjetë, pas emërimit të tij në Mat. Sikurse citohet nga burimi televiziv “Përmes rrëfimit të tij, ai shoqëron shikuesin në fëmijërinë e vet, frikën e mbetjes pa arsim të lartë për shkak të biografisë, si dhe nëpër sulmet dhe aleancat e pastra që formuan inxhinierin dhe gazetarin.” Më tej rreth pyetjes se “Sa i lidhur është Mero me fshatin dhe rrënjët e tij dhe si investon ai për to?” është një gërvishtje e lehtë intelektuale dhe patriotike, të cilën ai e thellon duke na treguar ringritjen nga rrënojat të një kishe dhe rigjenerimin e banesës ku lindi, si amanet dhe porosi e të Atit.

Kthim te rrënjët në Peshtan dhe dëshmia për krijimin e PD-së Mat, ky është një fragment-rrugëtim i Mero Bazes, ai rrugëtim që na mbush me frymëzim, që na jep një pasqyrë më të saktë të njohim jo vetëm penën që lexohet mjaft, por dhe njeriun e rrethuar me disa të panjohura në këtë fakt. Sikurse e cituam pra, dhe sipas emisionit në fjalë, RTSH e detyron atë që sjell përmes rrëfimit atë që e shoqëron shikuesin në fëmijërinë e tij, frikën e mbetjes pa arsim të lartë për



faj të biografisë, sulmet dhe aleancat që krijuan inxhinierin dhe gazetarin. Dhe kështu 40 minuta, personalitete të artit, kulturës, letërsisë, jetës politike e jo vetëm, rrëfejnë mbi fëmijërinë, rininë, personazhe e ngjarje, që kanë ndikuar në formimin e tyre. Sekrete, emocione, dobësi, analizë, rikthim në kohë e kujtime, që të mbajnë pezull. Një rijetim i momenteve kulmore në karrierën e tyre. Pasionë, hobi, pendesa. Gjithçka në një rrëfim ekskluziv për RTSH 1 HD, erdhi si një produkt në vijim i kësaj figure të talentuar, që nxënës model në letrësi në gjimnazin e Delvinës, një student, pos peripeçive të tjera që më në fund e bëri veten inxhinier, dhe një i emëruar diku larg, larg e shumë larg dhe ëndërrave të tij për gazetarinë që e kishte fituar me talent, por që duhej kohë ta ushtronte në të vërtetë.

E kështu Baze i njohur i shkrimeve pa kompromis, në këtë emision është një fëmijë, një rinosh, një student, një intelektual, një rrogëtar, një aktivist dhe në fund një njeri që ndjen edhe lotë edhe mall, për udhëtimin e tij afër dhe larg. Dhe në këtë hapësirë, në këtë realitet e këtë udhëtim real, mendoj se shumëkush mund ta ketë gjetur vetveten e tij ndoshta po në atë standart, në atë stad, në atë rrethrotullim imagjinar të një kohe në kohëudhë tjetër e me një mirëkuptim të heshtur e të ndjeshëm.

Baze i gazetës, i shtypit, por dhe i inxhinierisë së gjeologjisë së Matit, është midis të përditshmes dhe të shkruarës mes artit, është një realitet që lind nga moshë e tij rinore një poet, por që asnjëherë nuk e shpreh dhe mbetet modest, derisa duhej që Iliriana Zhupa poeti me emër nga Tepelena ta bënte të sinqertë dhe ardhjen e një vëllimi të tij të begatë kohët e fundit, ku duket jo vetëm poezi e mirëfilltë por dhe art. Mero Baze përmend me kenari të parët e tij, përmend të gjithë dhe natyrisht dhe mban respekt, flet për bashkëmoshatarë, flet për halle, vuajtje, frikëra dhe sjell ndërmend të Tjerët e afërt të një kohe, si Lazër Stanin, Faruk Myrtajn, Ilirian Zhupën, e mjaft të tjerë që iu ndeshën në udhën e tij dhe ai i gjen si intelektualë të ndjeshëm e me vlerë...

Për të lexuar shkrimin e plotë online, hapni kamerën e telefonit, drejtojeni nga kodi QR dhe klikoni mbi lidhjen që shfaqet për të vizituar www.fjalelire.com dhe revistën “Albanian Post”.



NDIQNI MODELIN E “BIG BOSS SEVICESS UK” LTD

Drejtuesi i Kompanisë shqiptare “Big Boss SeviceSS Uk” Ltd, z. Gazmend Cufaj shpjegon se asgjë nuk është më e rëndësishme sesa të kesh një ekip profesional për një biznes ndërtimi. Shumica e faktorëve të suksesit varen nga punonjësit tuaj, kështu që nuk mund të përballoni të keni punëtorë që dështojnë vazhdimisht në detyrat e tyre. Nëse mbuluesi juaj i çatisë nuk mund të ndërtojë një çati të mirëmbajtur, ose hidrauliku nuk është vërtet i mirë në riparimin e tubave dhe pajisjeve, klientët tuaj vështirë se do të jenë të kënaqur me rezultatet.

Ai sqaron se kur ndërtoni ekipin tuaj, përpikuni të punësoni profesionistë që kanë punuar tashmë në projekte të ngjashme dhe dinë si të sigurojnë rezultate cilësore. Por punësimi i punonjësve të

kualifikuar është vetëm gjysma e punës: shumica e suksesit varet nga mënyra se si biznesi juaj i ndërtimit do t'i trajtojë ata. Së pari, u ofroni atyre trajnim të mjaftueshëm në mënyrë që ata të mund të mësojnë të gjitha detajet që mund të kenë anashkaluar gjatë projekteve të tyre të kaluara. Nëse shihni që punonjësit tuaj shkëlqejnë në punën e tyre gjatë punës, tregoni vlerësimin tuaj me promovime, bonuse dhe shpërblime të ngjashme.

Z Cufaj thekson se parësore mbetet të vlerësoni Komunikimin dhe Punën në Ekip nga Brenda

Një mënyrë tjetër për të mbajtur një ekip të fortë dhe për të arritur sukses në ndërtim është duke pasur një rrjedhë të shëndetshme komunikimi midis punonjësve. Është thelbësore që të gjithë anëtarët

e ekipit tuaj të punojnë së bashku pa u përballur me ndonjë problem të madh keqkomunikimi. Për të mësuar më shumë rreth menaxhimit efektiv të një ekipi ndërtimi, shikoni elspierencën gjithnjë në rritje të kësak kompanie tashmë me emër në Britani të Madhe.

Më tej si çdo biznes duhet të ketë një vizion dhe deklaratë misioni të qartë. Pra, gjëja e parë që duhet të bëni është ta dokumentoni atë - përcaktoni objektivat e kompanisë suaj në seksionin e misionit dhe përshkruani atë që imagjinoni të arrini në të ardhmen në vizion. Kur të keni mbaruar këtë, mund të zhvilloni një plan të zbatueshëm për t'ju ndihmuar të arrini qëllimet e kompanisë suaj të ndërtimit. Krijoni metrika që do t'ju ndihmojnë të vlerësoni se sa mirë po ecën kompania juaj

dhe të festoni sa herë që shihni një rritje të konsiderueshme. Mos harroni se një nga mënyrat për të ndjekur strategjinë tuaj është ta ndani atë në pjesë më të vogla. Krijoni detyra të vogla, praktike, në të cilat mund të punoni ditë pas dite dhe të cilat, në të njëjtën kohë, ju ndihmojnë të arrini qëllimet tuaja më të mëdha. Menaxhimi i kohës është çelësi këtu, pasi do të mbeteni prapa pa ndjekur afatet kohore dhe momentet tuaja.

Sigurisht, thkeson drejtuesi Cufaj se ne e kuptojmë se është pothuajse e pamundur të keni gjithçka të planifikuar; prandaj do të ishte e dobishme për biznesin tuaj të ndërtimit të vlerësonte gjithashtu rreziqet dhe të kishte plane rezervë në rast se diçka shkon keq.

GREAT BUILDER

MODELI I RESPEKTIT NDAJ KLIENTIT

BIG BOSS SERVICES UK LTD

DREJTOR GAZMEND CUF AJ



NDUE PERLALA ME NJË VËLLIM POETIK, SI RRUGËTIM DREJT NJË APOLOGJIE TË HAPUR TË DEDIKIMIT


Ndue Perlala, si shumë autorë të tjerë të pas viteve nëntëdhjetë vjen nga radhët e ushtrisë. Dhe si i tillë me një disiplinë që e karakterizon në vetvete, ai ka prurë dhe disiplinuar mjaft mirë për lexuesin disa libra. Si fillim në vitin 2020-të ai ka botuar një libër me poezi të titulluar “Me syrin tek shtegu”, që natyrshëm nënkupton që në titull vëmendjen e një ushtaraku në kushte të tjera “disipline” dhe “lirie”, të shprehur në vargje dhe natyrshëm me mesazhin e një njeriu që ndjek dhe ndjen të gjithë ndryshimin e kësaj udhe të re. Dhe po në të njëjtin vit akumulimi i dijeve dhe njohurive të tij ka zbritur penën dhe memorijen të shkruaj e botoj “Paralelet e jetës” një libër ky me tregime, skica e rrëfime. Dy vjete më pas “Bija e largët” ka pasuar botimin disa skicave dhe tregimeve të tjera. Dhe më pas në vitin 2024 ai ka prurë për dashamirësit dhe lexuesit e tij “Një gotë verë” një përmbledhje me poezi.

Ndryshe nga të tjerët, nga botimet e mëparshme tek poezitë e “Një gotë verë” motivet janë më të shumta e më të larmishme. Në vetë sinopsin e këtij libri shkruhet: “Lexuesi gjen në to shpirtin delikat të poetit, forcën e tij shprehëse, nuhatjen e tij për të qëmtuar të bukurën ngado që shkon, por edhe për ta thënë fjalën me forcë kur shikon diçka që nuk shkon. Edhe k y është misioni i poetit. Të jetë jo vetëm gjahtar i motiveve e fjalës së bukur, por edhe luftëtar shoqëror për triumfin e së mirës dhe të bukurës në shoqëri.” Dhe ashtu sikurse citohet poezitë e këtij vëllimi janë poezi me motive njerëzore.

Së fundi ai ka prurë vëllimin

poetik të ri “Dardania ime” (2025) me redaktor poetin dhe gazetarin, publicistin dhe intelektualin e mirënjohur shqiptar, Ndue Lazri, i cili mbetet një figurë patriotike dhe intelektuale edhe në emigrim, në Itali ku jeton e angazhohet prej vitesh. Fantazinë e kopertinave poeti Perlala ia dedikon djalit të tij të talentuar, Eurialit dhe me ndjesitë letrare në vend të parathënies së artistets së madhe të folklorit të trojeve shqiptare, këngëtares, Mrika Trumshi. Në këtë vëllim nuk mungon dhe vlerësimi studimor i studiuesit dhe krijuesit të mirënjohur, Gjon Marku. Ky libër i përkujdesur nga Frano Kulli natyrisht meriton shumë respekt.

Me këtë gëzim të daljes së librit Ndue Perlala, organizoi para pak javësh një prezantim, promovim dhe bashkëbisedim me miq e dashamirës të tij në një mjedis tejet artsjellës. Miqtë dhe të pranishmit vlerësuan librin, krijimtarinë dhe përkushtimin tek “Dardania ime”. Por, jo vetëm me kaq, “Dardania ime” tashmë është një libër frymëzues. Përmbledhje të tilla poezish u shfaqën tek ky autor në vite, por shumë pak prej tyre mbijetuan me kalimin e kohës, falë angazhimeve të tjera, falë emigrimit, falë shëndetit dhe problemeve të tjera të integritetit dhe tranzicionit. Poezitë e tilla tejet të rëndësishme, dhe jo vetëm që mbijetuan, por edhe përcaktuan horizontet për poezinë e ardhshme të poetit Ndue Perlala, me seriozitetin e vetë poezisë, por edhe me notat tipologjike, me depërtimin e vargut të pakufizuar në natyrë dhe aurën qiellore, me respektin e saj për traditën dhe kundërshtimin e saj, me



njohjen e saj të shprehur të vetë jetikes dhe vetë jetës përkushtuese. Këta janë gjithashtu dedikimet në përgjithësi që poeti i dedikon deri në fund. Me librin e tij të parë, Ndue Perlala e shpalli veten si një poet të vërtetë, gjë që mbeti deri në fund.

Pra libri i fundit i Ndue Perlales, “Dardania ime” u botua si një përmbledhje e tij më gjithëpërfshirëse dhe e menduar me poezi, nga kompozimi deri te secila poezi dhe çdo fjalë. Në të, poeti shprehet plotësisht dhe me gjithë zemër. Në këtë prurje, poeti e paraqet veten si njeriun e thjeshtë, intelektualin e qetë, patriotin e denjë edhe për Dardanianën, ose Dardaninë e tij, sikurse vendos ai që në titull. Ndërsa kërkoja nëpër publikimet e tij online, nuk munda të mos e vëreja praninë e një arkipelagu të tërë strofash, vërejtjesh, shënimesh dhe apostrofash në poezi individuale... [...] Zgjedha më premtueset nga këto skica. Dhe i shtova ato në stilin tim. U përpoqa të mos

rivendosja asnjë “autenticitet” të supozuar të autorit në fjalë, por përkundrazi, të tërhiqja poezitë e tij individuale drejt zërit lirik, shpirtit dhe shkrimit të dorës nga fillimi i viteve të përkushtimit të tij. Këtu ai luan hapur para lexuesit, duke e paraqitur veten si një shtues në skicat e një vëzhguesi social, psikologjik dhe pse jo me detaje filozofike dhe në të njëjtën kohë - si një largim nga dhimbja e tij.

Poeti vazhdon këtë lojë në një aspektualitet diskursiv, ku supozohet se i karakterizon këto skica. Këtu toposet e peizazhit u sintetizuan në një imazh pothuajse fizikisht të prekshëm, ndjenja e dashurisë nuk u shtyp nga hapësirat boshe të distancës, skicat psikologjike ishin më të qeta sesa abstrakte dhe të mësuara dhe, ajo që është më e çuditshme, në shumicën e këtyre skicave spikat një peizazh paralel, metafizik i vizatimit, që tenton drejt një apologjie të hapur të dedikimit.

TREGU I RIMODELIMIT ËSHTË VAZHDIMISHT AKTIV

Drejtuesi i Kompanisë së ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd" Gazmend Cufaj, që nga krijimi e në vazhdim të punës profesionale si edhe tani në vitin 2025 kërkon planifikim dhe ekzekutim të kujdesshëm, duke marrë në konsideratë trendet e industrisë, kërkesat ligjore dhe kërkesat e tregut. Fokusimi në fusha specifike si ndërtimi i qëndrueshëm, ose tregtia e specializuar me këtë përkushtim i ofron kësaj kompanie tashmë me ëmër, avantazhe konkurruese. Përdorimi i softuerëve modernë të menaxhimit të ndërtimit dhe strategjive të marketingut dixhital është thelbësor për efikasitetin dhe rritjen, sikurse citon drejtuesi i Kompanisë.

Duke menduar se sipas të dhënave specifike të kësaj

fushe, Industria e ndërtimit parashikohet të rritet në vitin 2025, me sektorë specifike si banesat private dhe projektet e infrastrukturës që tregojnë



potencial të fortë, në fokus të kësaj kompanie është Qëndrueshmëria. Kjo e fundit ka një theks në rritje në praktikën e ndërtimit të qëndrueshëm, duke krijuar mundësi për kompaninë të mbetet faktor i specializuar

në ndërtimin miqësor ndaj mjedisit.

Duke parë se ërshtatja e Teknologjisë mbetet parësore, mjetet dixhitale si softuerët e menaxhimit të projekteve, softuerët e vlerësimit dhe sistemet CRM po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për efikasitetin dhe menaxhimin e klientëve të Kompanisë së ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd". Një plan gjithëpërfshirës është thelbësor për të përcaktuar qëllimet e biznesit, shërbimet e ofruara, parashikimet financiare dhe strategjitë operative. Kuptimi i rregulloreve lokale dhe kombëtare është thelbësor. Kjo përfshin regjistrimin e biznesit, lejet, sigurimin dhe pajtueshmërinë me standardet e sigurisë.

Eksploroni mundësi të ndryshme financimi si kredi, grante ose tërheqjen e investitorëve. Merrni në konsideratë kostot e fillimit që lidhen me pajisjet, sigurimin dhe marketingun fillestar.

Për këtë e të gjitha që qëndrojnë në vazhdimin përkushtues të Kompanisë për vitin 2005 është ndërtuar një ekip profesionistësh të aftë, duke përfshirë kontraktorë, nënkontraktorë dhe menaxherë projektsh, të cilët përputhen me vlerat dhe qëllimet e kompanisë së ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd". Tregu i rimodelimit është vazhdimisht aktiv, duke ofruar mundësi për kompaninë. Kompania e ndërtimit, "Big Boss Services UK Ltd" përqendrohet në praktikën e qëndrueshme të ndërtimit dhe metodat e ndërtimit me efikasitet energjetik.

BIG BOSS SERVICES UK LTD

BUILDING CONTRACTORS

Our services include:

Guttering
Painting
Decorating
Power Clean
Scaffolding
PVC Windows
Loft Covation

Plastering
Carpentry
Roofing
Brickwork
Tiling
Kitchen Fitting
Extensions
Bathroom Fitting





Gazmend Cufaj

**Thank you
so much!**

KONSULTIMI me ekspertët është
ZGJIDHJA MË E MIRË për ta
shmangur humbjen.



big_boss_services_uk_ltd



BigBossServicesUKLtd



@BigBossServices

Tel: 020 8591 9198
Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474
Email: bigboss-services@yahoo.co.uk
website: www.bigboss-services.webs.com
UTR: 7168616298
CRN: 8344897
VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës,
Tiranë dhe në
zonën e Plazhit
deri tek Mali i Robit

Kontakto:

07883029474 dhe 00355685309800

MBI NATYRËN E POEZISË DHE POLITIKËN E FJALËVE

Një temë e gjerë ka kohë që më ngacmon. Ajo vjen nga disa pyetje të tilla: Si ndikon poezia në shoqëri - dhe anasjelltas? A kanë poetët përgjegjësi të merren me çështjet politike dhe sociale në punën e tyre? Një realitet që më sjell këtë opinion...

Në jo pak raste përgjigja cinike është se poezia nuk ka rol, se ne poetët nuk kemi ndikim, kjo është një sferë krejtësisht e ndryshme. Por unë në fakt mendoj se bota e poezisë është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse në këto shoqëri tona të prishura, shohim se si njerëzit nuk mund ta imagjinojnë më tjetrin si qenie njerëzore. Ekzistojnë këto dështime të thella të imagjinatës, të aftësisë për të dëgjuar dhe për t'i kushtuar vëmendje. Dhe poezia është vendi ku mund të eksperimentojmë njëkohësisht me pyetje rreth asaj që mendojmë dhe ndiejmë, por edhe ku mund të dëgjojmë dhe shijojmë, sado fragmentare, tingullin e zërit njerëzor.

Më duket se kjo duhet të jetë baza për rivendosjen e bisedës në shoqëri. Në mungesë të kësaj baze, ekziston një tragjedi me përmasa globale. Qoftë në klasë, në familje, në qytet,

në vendin e punës, në shtet. Gjuha po zhduket. Ajo manipulohet në mënyrë të vetëdijshme dhe zbrazet nga përmbajtja, mjaft qëllimisht nga politikanë si ata që mbushin humorin nga Parlamenti ynë, mungesa e artikullimit strategjik të të cilit

Sidomos në çështjen e Çamërisë, ku poezia e dedikuar nga poetë të shumtë citohet vazhdimisht. Kur lexoj poezitë e poetes Arjana Gaba, më pëlqen të citoj poezitë e vëllimit të saj të fundit "Sytë e grua". Pra, poezia mund të shprehë

Çamërinë, ajo e bën atë me thjeshtësi dhe madhështinë e forcën e Poezive të saj.

Nuk jam i sigurt nëse poezia bashkëkohore ka ndonjë rol tjetër në politikë përveç kësaj, me të vërtetë. Mendoj se politikanëve, apo mburrarendësve politikë

dhe "patriotë" u pëlqen të zgjedhin poezi të caktuara dhe t'i përdorin ato për qëllimet e tyre. Por nuk mendoj se poetët janë ligjvënësit e panjohur të kësaj bote. Nuk mendoj se kjo është më e vërtetë. Dua të them, është padyshim një sport për disa. Profesor Doktor Zyhdri Dervishi, për shembull, është edhe studiues, edhe një poet dhe person interesant sepse ai mendon se poezia është gjëja më e rëndësishme në botë, por edhe se është plotësisht e qëllimtë. Kjo nuk është vetëm interesante, është e vërtetë.

Dhe le të përfundojmë shkurtimisht mbi natyrën e poezisë

dhe politikën e fjalëve. Kjo lidhje e ndërthurur natyrisht dhe sigurisht, ndryshon nga një vend në tjetrin. Ndoshta poezia duhet të jetë gjithmonë një hobi? Mendoj se është e çuditshme që po profesionalizohet, por ka dhe misionin e saj. Dhe ai është mjaft i qartë!



është një mjet tmerrësisht efektiv. Ekziston një zinxhir pandershmërie në gjuhë që është vërtet helmues. Unë supozoj se në këtë nivel, përmes poezisë, ne rivendosim besimin e mirë në përdorimin e fjalëve. Faktikisht nuk mendoj se poezia mund të ndikojë në politikë, por ka raste të çuditshme kur e bën.

ndjenja të caktuara në një mënyrë promovuese. Lexova një status cinik në Facebook. Nuk i marr në konsideratë këto gjëra, por sepse bënte me poezinë e poetes Arjana Gaba, jam i detyruar ta them këtë publikisht. Arjana Gaba është poete 24 karatëshe dhe ajo më së shumti nga shumë të tjerë, që shkruajnë artikuj për tu mburrur për

AT STAVRI ÇIPI NA BEKON ME ARTIN E FJALËS SË BUKUR

Poetin At Stavri Çipi për herë të fundit mbas shumë vitesh e pashë dhe shtrëngova duart në sallën e Bibliotekës “Qemal Baholli” në Elbasan, kur ai më nderoi në promovimin e librit tim poetik, “Dashuria Bekohet në Elbasan” vëllimi II. Dhe sa herë që e kujtoj, sa herë që e lexoj, gjithnjë e më shumë ndiej sikur po ia sakrifikon jetën jo vetëm Perëndisë, por edhe Poezisë. Tek ajo janë vetë Hyjnia dhe vetë filozofia e një poezie Supreme Në fakt mes të dyjave, e përditshmja, dhe vetë ajo është ajo që i shërben, ajo është ajo që i lutet, pra gjëja më e vërtetë në ditët e tij. Këto rrëfime të poetit i ndjek thuajse përditë në postimet e tij sociale, dhe në mendimin e tij rrëfyes ku më ngjan se të gjitha janë dhe lindën nga e njëjta nevojë, rezultat i së cilës është e gjithë poezia e tij, për t’u drejtuar lexuesve në një mënyrë depëruese dhe konfidenciale me qëllim që të ndajë me ta disa të vërteta domethënëse, të arritura personalisht. Me shumë mirësi e bekim, krijimtaria e tij letrare poetike është një reflektim i mençur mbi rrugën krijuese të dikujt, një lloj vlerësimi i përvojës artistike të akumuluar, mbi bazën e të cilit u afirmuan bindjet estetike për misionin e poezisë, për personalitetin dhe fatin e poetit, për natyrën e dhuratës krijuese, për procesin krijues. Duke zënë një vend të rëndësishëm në mendimin e poetit, tema e përditësisë dhe besimit dhe e krijimtarisë, si një temë konstante, si një bërthamë organizuese, është e pranishme në të gjitha poezitë e tij. Është edhe aty, pikrisht dhe aty ku duket se mungon nga jashtë.

Stavri Çipi është padyshim një dashamirës i vargut. Por jo vetëm kaq, ai është edhe një seleksionues i mesazhit. Është i tillë në vjershat e tij, në vargjet e tij, në poezitë e tij. Është tërësisht vetvetja, por krejt i lirë. I lirë nga përzgjedhja, i lirë nga

rëndësia e përzgjedhjes, por i qetë, në atë që ai kërkon të na e thotë me të vërtetë. Ky është një realitet. Një realitet, që vjen nga një njeri i tjeshtë, nga një poet i vërtetë. Një poet që me vargjet e tij, të bardha e të qarta, me rimë e pa rimë, na rrëfen dhe një dallim ku nënkuptojmë fare qartë se edhe ateizmi nuk është mosbesim!

Dhe pse e themi këtë? Mjafton të lexosh disa poezi të tij, si “Arrogantët”; “Të korrigjosh vetveten”; “Hëna kalëron ngadalë”; “Jam i lashtë tek dhë”; “Ne të pasurit e pamendte”; “O Zot, ti je bariu im”; “Kjo është bota”; “Kurrë nuk është vonë”; “Mos beso kot e më kot”; “Ca të nënës e ca të njerëz”; “Të jetosh mes dashurive”; “I lashtë qenkam tek ky breg” etj., është fare lehtë të nënkuptosh atë që në sociologji, në filozofi, sikurse edhe në fe ekziston një koncept - ateizmi, d.m.th. “paperëndishmëria” si antitezë e besimit në Zot - e teizmit. Dhe në këtë kontekst, po ashtu hyn thellë në një diskurs, që na rrëfen se nuk ka martirizim më të madh për njerëzimin sesa ky duel i teizmit dhe ateizmit. Nga poezi të tilla, të dala thjesht nga mendja dhe zemra e poetit, ne nënkuptojmë fare qartë se Zoti nuk mund ta mbajë “paperëndishmërinë” brenda Vetes, Ai nuk mund të jetë ateist për Vetën. Prandaj, ateizmi është një sjellje e njeriut. Dhe një martirizim i madh është kur dikush fal një besim për të pranuar një tjetër.

Me këtë rast, duke rilexuar e mirëkuptuar poezinë e At Stavri Çipit, si atëherë kur një shoku im i shkollës, Janaq Gjica, (I qoftë Shpirti në Parajsë) më pati folur për poezinë e Stavrit, por dhe kur pata lexuar disa dorëshkrime dua të sqaroj se vetë koncepti i “ateizmit” si etimologji është nga greqishtja e lashtë dhe përbëhet nga grimca α - parafjala “jo” dhe θεος – “Zot”. Dhe për këtë arsye duhet të përkthehet



si “paperëndishmëri”. Në një rast të tillë, ateizmi nuk mund të jetë një fe - një lidhje me diçka që është mbi ne, d.m.th. ateizmi nuk mund të ndërtojë një Hyjni. Për mua, sekretin në të është se është një manifestim dytësor, është një zëvendësues. Sepse gjëja parësore është se ekziston Theos - Zoti. Paperëndishmëria nuk mund të lindë nëse nuk ka gjë parësore. Pra, ateizmi si koncept, si një fenomen shoqëror lufton kundër diçkaje që nuk e pranon, por në vetvete nuk është një thelb, por një kontradiktë e asaj që ishte.

Gjëja e parë që duhet të vendosim si njohuri rreth ateizmit është se ai nuk duhet të ngatërrohet me atë që ne e quajmë mosbesim. Duhet të bëjmë një dallim themelor midis “mosbesimit” dhe “paperëndishmërisë”.

Por le të shkojmë më tutje në leximin e poezive të At Stavri Çipit, që mes të cilave mësojmë se nuk ka person që është në mosbesim, por varet prej vetë personit, ose sikurse thotë dhe këshillon poeti: “Mos beso kot e më kot”. Edhe pse çdo gjë që e ka ndërtuar atë është besimi,

pra besimi në vetvete, besimi në prindin e tij, besimi në një ideologji politike..., prapë se prapë mbetet këshilla poetike e Çipit një diksurs më vete. Pra, nëse do ta mirëkuptojmë mirëfilli, vetë besimi është një metodë dhe një rrugë me të cilën kryhet një sjellje e caktuar e një personi ndaj Zotit, ose ndaj një ideali. Por, sidoqoftë, edhe pytjetet variojnë, dhe ndonjëherë, është gabim të pyesësh nëse besimi shoqërohet vetëm me Zotin. Në literaturën materialiste, dhe veçanërisht në atë socialiste, kjo është pikërisht ajo që thuhet për ateizmin...

Për të lexuar shkrimin e plotë online, hapni kamerën e telefonit, drejtojeni nga kodi QR dhe klikoni mbi lidhjen që shfaqet për të vizituar www.fjalaelire.com dhe revistën “Albanian Post”.



SUPERMARKETI “HILAL” PËR TË GJITHË NE

Një nga supermarketet më në zë, ku mjaft shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare bëjnë blerjet e tyre të domosdoshme të ushqimeve, është dhe Hilal Supermarket që ndodhet në Kilburn High Road. Në këtë supermarket janë ushqimet që afrohen më shumë me ne. Ky supermarket me dëshirën e tij për të gjithë sqaron dhe një fjalë që ka hyrë më së shumti nga gjuhët e tjera.

Disa prej jush sigurisht keni dëgjuar se në produktet që i blejmë nëpër shitore mund të kenë përmbajtje jo hallall (haram). Disa prej nesh shikojnë me përpikshmëri përmbajtjen e çdo produkti që e blejnë. Shikojmë se mos ndoshta produktet përmbajnë alkool, mish derri etj etj. Tani flitet shumë edhe për një paletë tjetër të madhe produktesh që mund të përmbajnë sende haram. Prej tyre janë zhelatina (gelatine) dhe disa nga emulgatorët (E-numrat). Zhelatina është një produkt që përdoret në shumë produkte ushqimore. Përdoret në disa lloje të margarinave, si dhe në shumë ëmbëlsira, si psh. gumi bombonat (nga firma Haribo dhe nga firmat tjera), Resana, krem banane etj.

Sipas halal.de, 80% të zhelatinës që prodhohet në Europë prodhohet nga derri. Kurse sipas Ëkipedia 70% e zhelatinës në Europë prodhohet nga derri. Në Ëkipedia në gjuhën angleze është përqindja pak më e vogël, përshkak se aty përfshiet prodhimi në gjithë botën.

Pamarrë parasysh sa është përqindja, është e

mjaftueshme për neve që se paku ta vëmë në dyshim origjinën e zhelatinës. Kurse qytetari blerës që dëshiron të marrë ushqimin halal, duhet t'i mënjanohej sendeve të dyshimta, sepse ai i cili i largohet sendeve të dyshimta, i është larguar haramit.

Vërtet hallalli është i qartë, por edhe harami është i qartë. Ndërmjet tyre janë gjërat e dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dijnë. Kush m b r o h e t nga gjërat e dyshimta, e ka siguruar në pikëpamje të besimit dhe nderit, ndërsa kush ka rënë në gjërat e dyshimta, ka rënë në të ndaluarën, ngjajshëm sikur bariu, i cili e ruan kope në rreth vendit të ndaluar, në çast kopeja mund të ikë dhe të kullotë në të. Cdo sundues e ka vendin për të tjerët të ndaluar, kurse vendi i ndaluar i Allahut janë ndalesat e Tij. Në trupin e njeriut gjendet një copë mishi, kur ai është i shëndosh, i shëndosh është tërë trupi, kur ai priset, priset tërë trupi, Ajo copë mishi është zemra.



Në industri për ta ndihmuar dhe shpejtuar emulsionin, dmth përzierjen e ujit me vajin, përdoren disa substanca të ashtuquajtura emulgatorë. Gjithashtu edhe emulgatorët sikurse zhelatina përdoren me shumicë të produktet ushqimore. Keta emulgatorë në listën e përmbajtjes të ushqimit shkruhen me numra E XXX (p.sh. E 471, E 472 etj).

Një pjesë e madhe e emulgatorëve prodhohet prej yndyrësve të shtazëve. Në halal.de lista e emulgatorëve të dyshimitë

është e gjatë. Vlenë të përmendet se emulgatorët e lartpërmendur mund të jenë të prodhuara edhe nga bimët. Por për fat të keq nuk mund të dihet saktësisht se cilët emulgatorë prodhohen në këtë mënyrë. Keshtu që origjina e emulgatorëve është për momentin e dyshimtë.

Tek supermarketi “Hilal Food Centre” në Kilburn high Road çdo gjë është hallall dhe e kontrolluar, pasi zbaton me përikshmëri zgjedhjen dhe zgjidhjen e duhur të produkteve.

“HILAL FOOD CENTRE” NË KILBURN HIGH ROAD “SHTËPIA” E SHQIPTARËVE

A ka dikush tashmë nga shqiptarët e Londrës që nuk e njeh pronarin e “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road. Natyrisht që mund të jenë fare të pakët ata që nuk kanë bërë rrugëtimin e tyre në supermarketin në fjalë për të blerë ushqimet dhe produktet shqiptare, dhe që nuk e kanë ndjerë të flas

me ta si vëlla, si mik, si shqiptar i vërtetë. Ky është një fakt. Ky është një realitet. Dhe më tej sa herë e kemi parë vetë këtë mik të singertë e të vërtetë të shqiptarëve që të u vij në ndihmë njerëzve të thjeshtë, vetë familjarëve.

Në një kohë të tillë kur çdo gjë shkon në rritje, kur çmimet të japin një tronditje, respekti i tij mënjanon fitimin dhe gjithnjë u bën ulje. U bën ulje dhe mikpritje. Është i tillë i lindur nga vetë jeta, i rritur nga vetë eksperiencia. Ndaj ata që e njohin, dhe ata janë shumë e shumë gjithnjë thonë se e kanë vëlla, e kanë mik, e kanë njeri të zemrës së tyre. Kjo na bën të ndjejmë thellë respektin që

na shfaqet si një material i shtrenjtë i formës më të lartë diskursive.

Tashmë gjithkush e di se “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road është në kuptimin më të mirë figurativ “shtëpia” e shqiptarëve. E themi këtë se aty sipas proverbit shqiptar, “gjen dhe qumësht dallëndysheje”. Kjo gjithë nënkupton faktin se që nga krijimi, që nga fillimi i këtij supermarketi nën drejtimin

e tij kishte një pasqyrë të qartë të jetës shqiptare, të kuzhinës shqiptare, të nevojave që kanë familjet shqiptare në Londër. E kështu aty nis që nga kripa e mbaron tek produkti më i ri që prodhon e sjell në sy të shqiptarëve dita.

“Hilal Food Centre” në Kilburn High Road “shtëpia”

është një Realitet Shqiptar. Me optimizëm e doza inkurajuese çdokush tashmë vlerëson agrobizneset shqiptare me nota maksimale, duke i cilësuar impresionuese dhe mahnitëse, dhe për vetë faktin se ato janë burimi ku merr jetë kjo sfidë e madhe e ushqimit dhe produktit shqiptar që vjen e konsumohet në ishullin

të tjera, sidomos të Ballkanit. Ndaj është mirë që piku i sezonit të prodhimit të fruta-perimeve të shihet mirë nga instancat përkatëse që të ketë më shumë hapësirë ligjore dhe në Mbretëri të Bashkuar. Përsëherë shalqin, pjepër, mollë, dardhë, fiq, rrush, domate, kastraveca, kunguj, patëllxhanë e spec,

mashurka e bamje shqiptare nëse do të hynin në sezon në Londër natyrisht do të ishin një nga pikat ku do të sfidoheshin dhe më të fortët. Të gjitha këto fruta e perime janë pjesë e menusë sonë të përditshme, ndaj duhet me patjetër që të krijojnë udhë të reja ligjore drejt Britanisë.

Duke parë faktin se nga viti në vit, prodhimet shqiptare të fruta perimeve po shndërrohen në më të kërkuarat e tregjeve europiane për shkak të cilësisë së certifikuar të tyre ashtu si edhe shijes së vërtetë të tyre, ato duhet të jenë padyshim dhe në Britani të Madhe. Kur dihet fakti se eksporti i fruta-perimeve shqiptare (megjithë luftën për konkurrencë nga vendet fqinjë të

Shqipërisë) është konsoliduar dhe sa vjen e rritet, në tregun e brendshëm shqiptar ka një kaos përsa i përket vendeve ku shiten prodhimet vendase dhe ku është më e garantuar cilësia e tyre, ndaj duhet parë mundësia e lidhjeve tregtare jashtë, sidomos në BM. Kjo do ta shtonte akoma më shumë lidhjen e padiskutueshme tashmë të shqiptarëve me “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road.

Hilal Food Centre mbetet preokupimi im komunitar, vendi ku ushtroj më të mirën e mundshme që të zbatoj parimin. Eshërbimit të kulturuar, vlerës dhe respektit. Është supermarketi ku natyrshëm do të gjeni më të mirën e kërkuar, duke konkuruar e duke u përkushtuar.

Mirë se vini!

Investoni kohën tuaj me mençuri, është burimi i vetëm që nuk mund ta rimbushni



e shqiptarëve është një “Shqipëri e Vogël” në qendër të Londrës, ku ushqimet dhe produktet shqiptare konkurrojnë në cilësi e çmime me të gjithë produktet e tjera të Botës. Pra, produkte ‘Made in Albania’ janë prej vitesh tek “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road. Për shqiptarët e Londrës, dhe të Britanisë së Madhe, disa vjet më parë, do të ishte një Ëndërr Britanike, por për britanikët duket se

Britanik.

Krahas kësaj duhet shtuar se vetë Produktet Cilësore Shqiptare Rrisin Reputacionin e Shqipërisë në Britani të Madhe, pasi tek ky supermarket nuk janë vetëm shqiptarët që kërkojnë produkte cilësore shqiptare, por dhe etnitetet e tjera, ashtu sikurse ndodh që vetë shqiptarët në jo pak raste shijojnë dhe kërkojnë të provojnë produkte të shteteve



HILAL FOOD CENTRE

PAMJA E RE 2025

Supermarketi me produktet,
çmimet, vlerat, cilësinë e
ushqimeve, produkteve, mishit,
vezëve. Konkurren kudo!



Supermarket
special



Kontakto
02073721059



Email
INFO@HILALFOOD.CO.UK

MIRË SE VINI

